

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2020
- Statusi Ligjor: Organizatë Jofitimprurëse
- Selia Qendrore: Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: <https://allgreencentre.org/>
- Email kryesor i organizatës: allgreencentre@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 68 20 81 016

2. **Misioni:** Të afrojë njerëzit me natyrën për një mjedis të shëndetshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm.

3. **Vizioni:** Visioni i All Green Centre parasheh një Shqipëri me mjedis të shëndetshëm e që zhvillohet përmes zbatimit të politikave të qëndrueshme, duke plotësuar nevojat e së tashmes pa cenuar mundësitë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

Mbrojtja e mjedisit; Raportimi mediatik mjedisor dhe klimatik; Zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike; Advokimi dhe lobimi për politika të zhvillimit të qëndrueshëm; Zhvillimi i komunitetit.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

• “Dua ajrin tim” - Rritja e presionit qytetar për bashki më të pastra

Ky projekt synoi të rrisë presionin qytetar dhe të fuqizojë komunitetet lokale në Korçë dhe Pogradec për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit gjatë sezonit të ftohtë. U realizuan auditime energjetike në dy banesa për të vlerësuar fizibilitetin e termoizolimit si një zgjidhje efektive për uljen e ndotjes nga ngrohja shtëpiake, duke ofruar modele konkrete për investime të ngjashme në të ardhmen. U hartua një analizë kosto-përfitim për alternativat e ngrohjes, e cila i pajisi qytetarët me informacion të qartë për opsionet e qëndrueshme. Si pjesë e angazhimit qytetar, u organizuan dhe dorëzuan dy peticione drejtuar bashkive për të kërkuar masa konkrete, të cilat u shoqëruan me dy marrëveshje dakordësie për bashkëfinancim të termoizolimit. Qytetarët u trajnuan mbi mënyrat për të ushtruar presion institucional dhe u përfshinë aktivisht në fushata ndërgjegjësuere. Projekti solli rritje të dukshme të ndërgjegjësimit dhe aktivizimit qytetar, duke rritur presionin mbi bashkitë për të marrë masa për reduktimin e ndotjes sezonale të ajrit dhe duke vendosur një shembull të suksesshëm për pjesëmarrje komunitare në vendimmarrje mjedisore.

• “EkoSkaner” – Rritja e gazetarisë hulumtuese & Reporting climate change

Këto projekte synojnë të rrisin cilësinë, sasinë dhe ndikimin e gazetarisë hulumtuese mjedisore dhe klimatike në median shqiptare, përmes prodhimit të emisioneve, artikujve dhe platformave të dedikuara. Në kaudër të disa projekteve janë realizuar 22 emisione investigative televizive dhe 22 inserte hulumtuese, të cilat sollën në vëmendje problematika konkrete mjedisore që prekin komunitetet lokale. Paralelisht, janë publikuar mbi 30 artikuj mbi energjinë dhe ndryshimet klimatike. Platforma online www.ekoskaner.al u krijua si një hapësirë e vetme mediatike shqiptare e dedikuar për mjedisin dhe klimën. Projektet kanë ndikuar në rritjen e transparencës institucionale, ndërgjegjësimin publik dhe ndërtimin e një baze të besueshme informacioni për çështje mjedisore. U përfshinë aktivisht edhe të rinj, përmes praktikave të paguara dhe sesioneve të ndarjes së përvojës me studentë të gazetarisë.

• “Të rinj eficientë” – Rritja e ndërgjegjësimit rinor mbi masat e eficiencës së energjisë për një mjedis të shëndetshëm

Ky projekt synoi fuqizimin e të rinjve në qytetet Tiranë, Korçë dhe Pogradec për të ndikuar në politikbërjen mbi eficientësinë e energjisë, në funksion të një mjedisi më të pastër dhe të shëndetshëm. Nxënësit e klasave X dhe XI morën trajnim mbi masat e eficientësisë së energjisë, ndikimin e tyre në mjedis, ekonomi dhe shëndet. Përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe pjesëmarrjes aktive në aktivitete kreative si slogane, videomesazhe dhe takime me vendimmarrës, të rinjtë u angazhuan si qytetarë aktivë dhe kërkuar përmirësime konkrete në politikat mjedisore. Projekti arriti rritjen e ndërgjegjësimit rinor, si dhe shtoi

presionin qytetar ndaj institucioneve vendore për të ndërmarrë masa për reduktimin e ndotjes sezonale të ajrit në qytete.

- **Efficiency Youth**

Ky projekt kishte për qëllim fuqizimin e të rinjve për të ndikuar në zbatimin e politikave të eficiencës së energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në pesë qytete: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër. U realizua auditimi energjetik i pesë ndërtesave publike për të vlerësuar fizibilitetin e investimeve dhe për të krijuar një model të replikueshëm për bashkitë në të ardhmen. Gjithashtu, në 5 gjimnaze rreth 300 nxënës u trajnuan mbi masat e eficiencës së energjisë dhe ndikimin e tyre në mjedis, ekonomi dhe shëndet. Këshillat Rinorë vendorë u përfshinë në diskutimet mbi rezultatet e auditimeve energjetike, duke u njohur me mundësitë për të ndikuar në politikat lokale.

- **Budget 4 Balance**

Ky projekt synoi përfshirjen aktive të grave, vajzave dhe të rinjve në proceset e planifikimit, monitorimit dhe vendimmarrjes për buxhetin mjedisor dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në bashkitë Elbasan, Librazhd dhe Prrenjas. U monitoruan buxhetet bashkiake për periudhën 2022–2024 dhe u identifikuan boshllëqe në adresimin e çështjeve të mjedisit dhe klimës. Gra dhe vajza u angazhuan në analizimin dhe propozimin e masave konkrete për një planifikim më të qëndrueshëm. Gjithashtu, të rinjtë nga tre gjimnaze të përzgjedhura përfituan nga trajnime mbi buxhetimin e ndjeshëm ndaj klimës. Projekti përfundoi me një raport të detajuar të monitorimit dhe hartimin e një modeli të buxhetimit me pjesëmarrje, i cili u promovua si praktikë e mirë në nivel lokal.

- **“Monitoring for Sustainability”**

Ky projekt synon të parandalojë korrupsionin në përdorimin e tokës në bashkitë Devoll dhe Kolonjë, përmes monitorimit të vendimeve vendore dhe përfshirjes aktive të komunitetit lokal në rajonin e Korçës. Në fokus janë ndryshimet e përdorimit të tokës nga fondi pyjor/kullosor në instalime industriale si centralet fotovoltaike, duke u monitoruar për një periudhë 3-vjeçare. Projekti synon gjithashtu fuqizimin e grave, vajzave dhe të rinjve përmes trajnimeve, pjesëmarrjes në advokim dhe ndjekjes së vendimmarrjes publike. Përfituesit përfshijnë komunitetin lokal, shkollat e mesme, OJF-të dhe vetë institucionet vendore. Rezultatet kryesore përfshijnë një raport monitorimi me plan masash, rritje të transparencës në bashki, përfshirje të të rinjve në shkolla dhe përhapje të modelit në nivel kombëtar. Fushata përfshin gjithashtu një dokumentar investigativ dhe një paketë të gjerë informuese e ndërgjegjësuere në media.

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata operon kryesisht në Shqipëri, me fokus në qytete dhe rajone ku sfidat mjedisore dhe përfshirja qytetare janë më të theksuara. Ndër vite janë zbatuar projekte që përfshijnë Korçën, Pogradecin, Tiranën, Durrësin, Elbasanin, Librazhdin, Prrenjasin, Vlorën, Shkodrën, etj. Aktualisht, ka projekte aktive në: Qarkun e Korçës dhe veçanërisht në bashkitë Devoll dhe Kolonjë, si dhe projektet që përfshijnë të gjithë territorin e vendit.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv: Ola Mitre

Bordi i Drejtuesve: Albert Hitoaliaj, kryetar; Esmeralda Çuni, anëtare; Klajdi Merxhani, anëtar

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet

All Green Centre ka bashkëpunuar me një sërë partnerësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, dhe është mbështetur financiarisht nga donatorë si: Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Bashkimi Evropian, Qeveria Gjermane, Ambasada e SHBA në Tiranë dhe organizata të tilla si GIZ, Internews, DW Akademie, Investigative Network Albania, Master Peace, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, IDM, etj.

9. Ndikimi

Disa nga rezultatet dhe arritjet e matshme të organizatës përfshijnë:

- Më shumë se 800 të rinj të trajnuar mbi eficiencën e energjisë, ndryshimet klimatike dhe pjesëmarrjen qytetare në 10 bashki të vendit;

- 7 auditime energjetike të realizuara në ndërtesa publike dhe banesa, me rekomandime për investime të qëndrueshme;
- 22 emisione televizive investigative të transmetuara në nivel kombëtar dhe mbi 30 artikuj të publikuar për çështje mjedisore dhe klimatike;
- 1 platformë kombëtare e dedikuar gazetarisë mjedisore dhe klimatike (www.ekoskaner.al);
- 2 peticione të mbështetura nga mbi 300 qytetarë për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Korçë dhe Pogradec;
- 7 marshime qytetare për të kërkuar politika mjedisore;
- 4 marrëveshje bashkëpunimi me bashki për angazhimin rinor në çështjet e mjedisit dhe klimës.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet

Një nga episodet e emisionit “EkoSkaner” u nderua me Çmimin e Bashkimit Evropian për Gazetari Investigative në Shqipëri për vitin 2022. Emisione të tjera nga cikli “EkoSkaner” janë vlerësuar me çmime kombëtare në fushën e gazetarisë mjedisore, duke dëshmuar cilësinë dhe ndikimin e tyre në forcimin e llogaridhënies publike dhe ndërgjegjësimin qytetar. Organizata është prezantuar gjerësisht në mediat kombëtare dhe lokale përmes artikujve, intervistave dhe kronikave mbi projektet që lidhen me ndryshimet klimatike, ndotjen e ajrit dhe përdorimin e tokës.